

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“Europe Insight Research” Sh.p.k**



Sot më datën 01/02/2024 personat juridike dhe fizike si më poshtë vijon:

**1. Shoqëria MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L – shkurt MPS SRL, me Seli** ne Bergamo, Itali, Rruga Gabriele Rosa Nr.28, me NIPT: 02008480168 – REA, Nr. 254759, **perfaqesuar z.Antonio Federico DI MARCO PERNICE** i biri i Vittorio i datelindjes 17/01/1965, lindur ne Torre Boldone (BG) dhe banues ne Via Pietro Ruggeri da stabello 8L CAP 24123 Bergamo, Itali, disponues i pasaportes me Nr.YB1892352, **emeruar perfaqesues me Vendimin date 15/01/2024, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L.**

**2. Elton KOÇIU** i biri i Muarem i datëlindjes 11/05/1978, me Nr.Personal: H80511068H, lindur ne Korçë, dhe banues në Tiranë, me adrese Njesia Administrative Nr.7, Rruga “Ylberë Bylykbashi”, Nd.5, H.2, disponues i pasaportes me Nr.BG9430593.

**Vendosën: të themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin: “Europe Insight Research” Sh.p.k si më poshtë vijon në bazë të Ligjit Nr.9901, date 14/04/2008:**

Neni 1

**Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në pajtim me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) me emërtimin “Europe Insight Research” Sh.p.k.**

**Ortakët e Shoqërisë “Europe Insight Research” Sh.p.k janë:**

- 1- Shoqëria MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L – shkurt MPS SRL.**
- 2- Elton KOÇIU.**

**Administrator i shoqërisë është z. Elton KOÇIU, i cili emërohet në këtë detyrë për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.**

**Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.**

Neni 2

**Shoqëria “Europe Insight Research” Sh.p.k, gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.**

**Selia e Shoqërisë “Europe Insight Research” Sh.p.k është ne Rrugen e “Kavajes”, Nr.40 Kati i katert prane ish Njesise Bashkiake Nr.7 peballe Poliklinikes Nr.9, Tirane Shqiperi.**

**Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij Akti Themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.**

**Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen “Shoqëria “Europe Insight Research” Sh.p.k, Tirana, Albania.**

Neni 3

**Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhe kohe mbi 10 vjet.**

Neni 4

**Shoqëria "Europe Insight Research" Sh.p.k ka si objekt të veprimtarisë ekonomike:**

- Jep shërbime të tregu dhe në veçanti:
  - Marketing, Marrëdhënie me publikun, studime tregu, Studime statistikore, sondazhe opinioni, fushata komunikimi digjitale dhe jo vetëm, studime të strategjive të biznesëve.
  - Konsulencë dhe përpunim të dhënash për studime tregu kombëtare dhe nderkombëtare.
  - Studime tregu Kombëtare dhe Nderkombëtare
  - Sondazhe Kombëtare dhe Nderkombëtare
  - Studime mjeksore, kombëtare dhe nderkombëtare.
  - Ndermjetësim, nenkontraktim dhe bashkëpunim me subjekte vendase dhe të huaja.

**Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqindmijë) Lekë i shlyer dhe i nënshkruar tërësisht nga ortakët. Kapitali dhe kuotat ndahen ndërmjet ortakëve si më poshtë vijon:

**1- Shoqëria MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L, zoteron 1 kuote me vlerë nominale 70.000 (shtatëdhjetëmijë) Leke e barabarte me 70 % (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.**

**2- Elton KOÇIU, zoteron 1 kuote me vlerë nominale 30.000 (tridhjetëmijë) Leke e barabarte me 30 % (tridhjetë) të kapitalit themeltar.**

**Bilanci, Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

**Neni 6 Bilanci**

Bilanci i shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga ekspertët kontabelë i autorizuar nga administratori miratohen nga asamblëja. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.



**Neni 7 Dividendët**

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

**Neni 8 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e paspërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

**Neni 9**





Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kesaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortakët e shoqërisë nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tyre që nuk bën pjesë në kapitalin themelues të shoqërisë.

#### Neni 10

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### Neni 11

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e shoqërisë përcaktohen në statutin e saj.

#### Neni 12

**Kontaktet e Shoqërisë "EUROPE INSIGHT RESEARCH" Sh.p.k janë si më poshte vijon:**

**Email: europeinsightresearch@gmail.com**

**Tel: +355695655171.**

#### Neni 13

Themeluesit e shoqërisë si e lexuan me vëmendje akt themeluesin e mësipërm dhe e gjetën konform vullnetit të tyre e firmosin pa vërejtje.

### ORTAKËT E SHOQËRISË

**Shoqëria MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L  
perfaqesuar z. Antonio Federico DI MARCO PERNICE**

*Antonio Federico Di Marco Pernice*  
*Antonio Federico Di Marco Pernice*

**Elton KOÇIU**

*ELTON KOÇIU*

*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ARTAN H. TRESKA



DATE 01/02/2024  
NR REP 395



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot më datë 01/02/2024 në Studion Noteriale të ndodhur në Rrugën e “Kavajës”, Tiranë, para meje noterit **Artan TRESKA**, u paraqiten personalisht:

**1. Antonio Federico DI MARCO PERNICE** i biri i Vittorio i datelindjes 17/01/1965, lindur ne Torre Boldone (BG) dhe banues ne Via Pietro Ruggeri da stabello 8L CAP 24123 Bergamo, Itali, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identifikuar nga pasaporta me Nr. YB1892352, me cilesine e perfaqesuesit te Shoqerise **MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L – shkurt MPS SRL**, me Seli ne Bergamo, Itali, Rruga Gabriele Rosa Nr.28, me NIPT: 02008480168 – REA, Nr. 254759, emeruar perfaqesues me Vendimin date 15/01/2024, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise **MARKETING PROBLEM SOLVING S.R.L.**

**2. Elton KOÇIU** i biri i Muarem i datëlindjes 11/05/1978, me Nr.Personal: H80511068H, lindur ne Korçë, dhe banues në Tiranë, me adrese Njesia Administrative Nr.7, Rruga “Ylberë Bylykbashi”, Nd.5, H.2, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identifikuar nga pasaporta me Nr.BG9430593.

**Anila BERBERI** e bija e Petrit e datëlindjes 15/08/1972, me Nr.Personal:H25815062P, lindur ne Bilisht te rrethit Korçë dhe banuese në Tiranë, me adrese, Njesia Administrative Nr.10, Rruga “Gani Luzi”, Nd.7, H.6, Ap.26, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar e njohur personalisht prej meje noterit, (me cilesine e perkthyeses zyrtare te gjuhes italiane).

Z. Antonio Federico DI MARCO PERNICE dhe z.Elton KOÇIU deklaruan para meje noterit se Akti i Themelimit te mësipërm për krijimin e Shoqërisë “Europe Insight Research” Shpk është hartuar prej tyre me vullnet të lirë dhe të plotë.

Akti i Themelimit për krijimin e Shoqërisë “Europe Insight Research” Shpk iu lexua z.Antonio Federico DI MARCO PERNICE ne gjuhen italiane nga perkthyesia zyrtare e gjuhes italiane znj.Anila BERBERI dhe ne perfundim z.Antonio Federico DI MARCO PERNICE deklaroun se e kupton e pranon dhe se ne te eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.

Pas ketyre hapave z.Antonio Federico DI MARCO PERNICE dhe z.Elton KOÇIU, nenshkruan rregullisht para meje noterit, dhe une noteri duke e gjetur ate ne perputhje me ligjin, e vertetoj.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018“Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERI  
**Artan TRESKA**

PERKTHYESIA  
**Anila BERBERI**

01.02.2024